



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS ITALIANE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Gjuhë e Huaj për qëllime specifike

Ngarkesa: 6kredite; 60 orë mësimore; 30 leksione / 30 seminare

Viti / Semestri : Viti II, semestri I

Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme

Programi i studimit: Master i Shkencave në “Mësuesi e gjuhës italiane për arsimin e mesëm të lartë”

Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJET DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshme lëndore:

Studenti duhet të jetë i aftë të: përvetsojë një leksik specifik, terminologjik të fushave të ndryshme me karakter shoqëror. Te analizojë material të fushave të ndryshme shoqërore duke zgjidhur problemet që lidhen me argumentet, analizat, diskutimet që rrjedhin nga këto materiale. Te organizojë dhe zgjidhë punën kërkimore dhe hulumtuese në mënyrë të pavarur.

Objektivat specifike lëndore:

Studenti duhet të jetë i aftë të:

1. Përvetsojë një fjalor terminologjik, specifik të shkencave shoqërore të ndryshme, të cilin nuk e zoteron deri tani.
2. Të jetë në gjendje të analizojë, përpunojë dhe diskutojë mbi një material me karakter shkencor të fushave të ndryshme shoqërore.
3. Të seleksionojë vështirësinë e një materiali të llojit të lartepërmendur dhe kultivojë aftësitë për të ditur t'i shfrytëzojë në këto materiale në didaktikën e gjuhës italiane.

Rezultatet e pritshme:

1. Studenti do të përvetësojë një fjalor të pasur terminologjik të shkencave shoqërore në gjuhën italiane, duke e përdorur atë në mënyrë të saktë në të folur dhe të shkruar.
2. Studenti do të jetë në gjendje të analizojë në mënyrë kritike dhe të interpretojë materiale me karakter shkencor nga fusha të ndryshme shoqërore, duke identifikuar dhe diskutuar problemet dhe argumentet kryesore.
3. Studenti do të zhvillojë aftësinë për të përdorur materialet autentike dhe shkencore në kontekste didaktike, duke i integruar ato në orë mësimore ose në detyra kërkimore në mënyrë të pavarur dhe efektive.